

Njoftim për punësim

Termat e Referencës (ToR)

Fizioterapist, për të ofruar shërbime mbështetëse për gratë, fëmijët dhe grupet e tjera vulnerabël në Bashkinë Elbasan (shërbime në ambjentet e qendrës sociale “Balashe” dhe shërbime lëvizëse).

Titulli i projektit	“Zgjerimi i shtrirjes dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit social të Qendrës Sociale Balashe për fëmijët dhe familjet në nevojë” (EMBRACE BALASHE)
Pozicioni	Fizioterapist
Lloji i kontratës	Kontratë pune individuale me kohë të pjesshme (7 muaj)
Zona e zbatimit	Elbasan

Informacion i përgjithshëm mbi organizatën:

Themeluar në vitin 2011, Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA) është një OSHC rome e cila qëndron për një shoqëri multi-etnike dhe gjithëpërfshirëse që bazohet në parimet universale të të drejtave të njeriut dhe barazisë.

Misioni i organizatës është të mundësojë një zhvillim të barabartë dhe të qëndrueshëm të komuniteteve rome nëpërmjet avokimit, mobilizimit, fuqizimit, bashkëpunimit, hulumtimit të orientuar drejt politikave, veprimit dhe kërkimit pjesëmarrës, si dhe pjesëmarrjes së barabartë në proceset demokratike, akses të barabartë në të drejta dhe shërbime dhe promovim i kulturës dhe identitetit rom.

Informacion rreth projektit:

Projekti “Zgjerimi i shtrirjes dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit social të Qendrës Sociale Balashe për fëmijët dhe familjet në nevojë (EMBRACE BALASHE)” është duke u zbatuar nga Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri – IRCA në partneritet me Bashkinë e Elbasanit. Ky projekt zbatohet me mbështetjen e programit të Bashkimi Evropian për Kujdesin Social (EU4SocialCare) i financuar nga BE dhe i zbatuar nga UNICEF Albania dhe Eorl Vision Albania.

Modernizimi i Qendrës Sociale “Balashe” me qëllim ofrimin e shërbimeve dinjitoze dhe cilësore për të gjithë përfituesit është themeli i strategjisë së projektit. Projekti do të mbështesë krijimin e protokollit të shërbimeve të integruara, si dhe planin operacional të Qendrës Sociale Balashe për ofrimin e shërbimeve të integruara (shërbime lëvizëse dhe në ambientet e qendrës), duke forcuar partneritetin me shërbime të tjera ekzistuese, për të siguruar mbështetje gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme për të gjithë anëtarët e komunitetit. Shërbimet përfshijnë: shërbime psikologjike dhe fizioterapeutike, mbështetje pas shkolle për fëmijët, si dhe lehtësim për zhvillimin e aftësive dhe punësimit.

Prezantimi i njësisë lëvizëse të kujdesit social do të sjellë një përparim të madh në ofrimin e shërbimeve sociale për Elbasanin. Kjo njësi do të veprojë si një zgjatim i Qendrës Sociale Balashë, duke ofruar shërbime përmes njësisë lëvizëse drejtpërdrejt për personat me aftësi të kufizuara, komunitetet e cënueshme dhe të marginalizuara. Kjo qasje do të risë ndjeshëm cilësinë e kujdesit dhe do të ulë pengesat për akses, veçanërisht për ata me lëvizshmëri të kufizuar, ata që jetojnë në zona të largëta apo individët të cilët nuk mund të aksesojnë shërbimet në qendër për arsye të ndryshme.

Qëllimi i shërbimit:

IRCA kërkon të punësojë një Fizioterapist me kohë të pjesshme, për të ofruar shërbime mbështetëse për fëmijët, gratë dhe grupet e tjera të marxhinalizuara në Bashkinë Elbasan, në përputhje me nevojat e target grupeve dhe në bashkëpunim me stafin e qendrës Sociale Balashe dhe Shërbimin Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen në Bashkinë Elbasan.

Fizioterapisti do të ketë për detyrë të zbatojë në kohë dhe me cilësi aktivitetet e projektit në Bashkinë Elbasan (Shërbime në ambjentet e Qendrës Sociale Balashe dhe shërbim lëvizës).

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Fizioterapisti i cili ofron shërbime në Qendrën Sociale Balashe në Elbasan dhe shërbime lëvizëse ka përgjegjësi të rëndësishme në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies fizike të përfituesve të projektit. Detyrat kryesore përfshijnë:

- Kryerja e vlerësimeve të detajuara për të identifikuar nevojat specifike të përfituesve.
- Hartimi i planeve individuale të trajtimit bazuar në vlerësimet e kryera.
- Ofrimi i seancave të rregullta të fizioterapisë në ambjentet e qendrës, duke përdorur pajisjet e përshtatshme.
- Përdorimi i teknikave të ndryshme terapeutike për të përmirësuar lëvizshmërinë dhe funksionin fizik të përfituesve.
- Ofrimi i shërbimeve fizioterapeutike në shtëpi për ata që nuk kanë mundësi të frekuentojnë qendrën, duke siguruar vazhdimësinë e kujdesit.
- Përshtatja e terapive sipas kushteve të ambientit shtëpiak dhe nevojave individuale të përfituesve.
- Trajnimi i përfituesve dhe familjarëve të tyre mbi ushtrimet dhe teknikat që mund të praktikohen në shtëpi për të mbështetur rehabilitimin.
- Ofrimi i këshillave për parandalimin e dëmtimeve dhe përmirësimin e posturës dhe lëvizshmërisë.
- Bashkëpunon me ekupe multidisciplinare për të siguruar një qasje të integruar në kujdesin ndaj përfituesve.
- Merr pjesë në takimet periodike të grupit ndërsektorial që do të organizohen në kuadër të projektit.
- Merr pjesë në aktivitetet për rritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve sociale që do të organizohen në kuadër të projektit.
- Referon rastet e identifikuar me risk të lartë për shërbime më të specializuara.
- Bashkëpunon me stafin e projektit për arritjen e rezultateve dhe treguesve të pritshëm të projektit të ofruara në përputhje me procedurat financiare dhe administrative të projektit dhe për respektimin e standardeve profesionale dhe etike në punën e tij.

- Mbajtja e regjistrave të sakta dhe të përditësuara për çdo përfitues, duke dokumentuar vlerësimet, planet e trajtimit dhe përparimin e arritur
- Raportimi i rregullt të ekipi koordinues mbi ecurinë e terapive dhe çdo çështje që kërkon vëmendje të veçantë.

Përmes këtyre detyrave, fizioterapisti luan një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetës së përfituesve, duke i ndihmuar ata të arrijnë një nivel më të lartë të pavarësisë dhe mirëqenies fizike.

Kualifikimet dhe eksperiencia:

- Diplomë e nivelit **Bachelor ose Master në Fizioterapi.**
- **Licencë e vlefshme** për ushtrimin e profesionit të fizioterapistit, sipas legjislacionit në fuqi në Shqipëri.
- **Përvojë minimale 2-3 vjet** në fizioterapi.
- Njohuri të thelluara në teknikat e fizioterapisë, rehabilitimin fizik dhe metodat e trajtimit të lëvizshmërisë.
- Aftësi për të hartuar dhe zbatuar **plane individuale të trajtimit** bazuar në nevojat e përfituesve.
- Njohuri mbi përdorimin e **pajisjeve fizioterapeutike** dhe teknologjive të reja në rehabilitim.
- Aftësi për të edukuar dhe trajnuar pacientët dhe familjarët e tyre për ushtrime dhe teknika mbështetëse.
- Eksperiencë në **ofrimin e shërbimeve fizioterapeutike në shtëpi** ose në qendra sociale.
- Puna me ekipe multidisciplinare në qasje të integruar të kujdesit shëndetësor.
- Eksperiencë në organizata të shoqërisë civile ose projekte të lidhura me rehabilitimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për grupet vulnerabël.
- Aftësi në komunikim, empati dhe ndërtimin e marrëdhënieve të mira me pacientët dhe familjet e tyre.
- Fleksibilitet dhe gatishmëri për të ofruar shërbime lëvizëse jashtë qendrës.
- Të kuptojë dhe të dakortësojë me misionin dhe qëllimin e IRCA

Procedura e aplikimit:

Personat e interesuar duhet të dergojnë brenda dates 14 mars 2025 (shtyhet deri ne 28 mars 2025, rishtyhet ne 15 Prill 2025) në adresën e emailit institute.irca@gmail.com ose prokurime.irca@gmail.com ose fizikisht prane zyrave te IRCA dokumentat si më poshtë::

- një kopje të jetëshkrimit profesional (CV)
- një letër interesi
- oferte financiare

Vemendje:

Në subject të e-mailit të vendoset: Aplikim për pozicionin Fizioterapist ne kuader te projektit EMBRACE Balashe.

Kriteret e vlerësimit

Aplikimet do të vlerësohen bazuar tek kriteret e mëposhtme:

Kriteret e vlerësimit	Vlera në %
Edukimi	30%
Eksperienca e mëparshme relevante	40%
Oferta financiare	30%

Vetëm kandidatët që ftohen për intervistë do të njoftohen për vendimin e përzgjedhjes. Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri – IRCA rezervon të drejtën të mos informojë kandidatët e refuzuar për arsyet e refuzimit të tyre.

Shënime të rëndësishme:

-Të gjithë personat e përfshirë në programet e IRCA, duke përfshirë stafin e brendshëm, stafin e jashtëm, ekspertët, kontraktorët, vullnetarët dhe mbështetësit, janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, masat kundër abuzimit dhe shfrytëzimit seksual, rregulloret e brendshme të IRCA-s, kodin e sjelljes, si dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu, ata duhet të jenë të informuar dhe të zbatojnë çdo dokument tjetër të rëndësishëm në këtë fushë.

-Të gjithë individët që angazhohen në marrëdhënie bashkëpunimi me IRCA nënshkruajnë kontratat përkatëse dhe politikat e IRCA-s, të cilat përshkruajnë të drejtat dhe përgjegjësitë e secilës palë.

-IRCA është një organizatë e bazuar në vlerat e meritokracisë. Çdo ndërhyrje në procesin e përzgjedhjes çon në skualifikimin e menjëhershëm të kandidatëve.

-IRCA ka politika që dënojnë çdo formë abuzimi apo diskriminimi për shkak të moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, orientimit seksual, etj